

KOSTAQ KONOMI

BIBLIOTEKA  
SHTEIT

314-1  
K 87



LULE,  
DJEMTË  
E NËNAVE!

p o e z i

814-1  
            
K 87

KOSTAQ KONOMI

# LULE, DJEMTË E NËNAVE!

— poezi —



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## KËNGËT E POPULLIT TIM

Që kur linda  
m'i vendosën në djep te koka.  
Ishin si një tufë trëndelinë e lulegjeshtre  
mbledhur me sakrifica në bokërrimat e shekujve.

Që kur linda  
m'i dhanë trazuar me qumështin e gjirit,  
me puthjet, me përkëdheljet,  
që të bëhesha dyfish:

njeri i mirë dhe atdhetar

Dhe u mësova me këto këngë  
si me aromën e luleve,  
u mësova si me cicërimat e zogjve,  
u mësova si me frymën e erërave,  
si me shpërthimin e dallgëve...

U mësova me këngët e popullit tim,  
të bukurat,

të pazëvendësueshmet,

ndaj i mbart në qënien time kudo që shkoj,  
siç mbart emrin e mirë «shqiptar»,  
siç mbart mbiemrat i «ndershëm»,

«besnik»,

«luftëtar».

## GRUSHTET E SHTRËNGUAR

(Në ditën e betimit ushtarak)

Sot pesë gjishtërinjtë e dorës  
u mblodhën grusht pranë ballit tim  
dhe u shtrënguan fort.

Sot të gjithë i kanë shtrënguar grushtet.  
Këto grushte 19-vjeçarësh  
janë zemrat tona të vendosura besnikërisht  
pranë yllit të kuq të bustinës,  
në roje të uzinave, pallateve, rrugëve...  
Në roje të tokës që e lamë atje në fshatrat  
e largët të vendlindjes,  
në roje të tufave që i lamë duke kullotur atje  
në bjeshkët dhe shpatet e maleve,  
në roje të fëmijëve që i lamë duke rendur në  
shkollë me çantat e librave.

Sot të gjithë shtrëngojnë grushtet.  
Këto qindra grushte,  
si qindra granata më duken sonte,

si qindra granata që me një sinjal janë gati  
të hidhen  
mbi kokat e agresorëve...

Në pesë gishtërinjtë e dorës shtrënguar  
mbajmë gjithë dashurinë  
dhe gjithë urrejtjen.

## KAM NEVOJË

Kam nevojë për fjalë të ngrohta,  
siç kanë bimët për ngrohtësinë e diellit,  
siç kanë fëmijët për dashurinë e nënës.

Kam nevojë edhe për fjalë të vrazhda,  
siç ka hekuri për të rrahurit e kovaçit,  
siç kanë pemët për gërshtëren e kopshtarit.

Kam nevojë për fjalën tënde, Parti,  
në çdo kohë,  
qoftë e vrazhdë,  
qoftë e ngrohtë.

## NË VAPORIN E MBYTUR

Dallgët e urrejtjes e përpinë,  
dallgët e urrejtjes e rrahin vazhdimisht...

Në detin e zemërimit tonë,  
imperatoria e egër u mbyt...

Guackat e detit dhe ndryshku  
brejnë «lavdinë» e saj...



## DUKE ARDHUR

Kur më dëgjon të mërmëris ndanë arës me  
mos pandeh se jam zemëruar me ty. grurë,

Jo, jo.

Po fjalosem me arën

si me ty,

po fjalosem me grurin

si me tim bir.

Po fjalosem me sytë e shokëve,

që i gjej përherë këtu në arë,

po fjalosem me djersën time,

që u kthye në kalli qelibar...

Kur më dëgjon të mërmëris ndanë arës

me grurë,

dua të lajmëroj se po vij,

i qeshur,

i lumtur,

plot gjallëri.

## NË ÇASTE HIDHËRIMI

Fytyra jote mori pamjen e qiellit,  
që ngarkohet me re.  
Sytë e tu morën pamjen e flakëve,  
që iu lëkundën gjuhët.  
Buzëqeshja jote mori pamjen e qiririt  
që shuhet  
dhe nofullat e tua si dy shkëmbinj,  
që rrinë mbi njëri-tjetrin...  
Pastaj një fjalë shkrepëtiu  
si rrufeja në qiellin e vrejtur:  
«Vendin e vëllait të vrarë,  
po e zëvendësojë, vëllezër!»

## BASHKËFSHATARËT

Si dielli  
këta fshatarët e mi:  
gjithë ditën  
bimëve në ara u japin  
dritën e mendjes  
e ngrohtësinë e zemrës;  
dhe kthehen nga puna  
çdo mbrëmje të lodhur,  
por të lumtur  
me të nesërmen në sy...



Vazhdimisht.

Më ngjan kështu  
më kurthet dhe intrigat e armikut  
të klasës.

Rris vigjilencën.

## SHKËMBI I KATERINËS

Në fshatin tonë  
shtatin ka pas hedhur dikur një lastar,  
erën ka pas shpërndarë një trëndelinë.  
Në fshatin tonë  
ka pas jetuar një vajzë,  
që thirrej Katerinë.

E varfër si dimri,  
e mjerë si jetime,  
e palodhur si bletë,  
e pastër si kristali  
në fshatin tonë  
shtatin ka pas hedhur dikur një shoqe e vjetër,  
krahët ka pas nderë një ferrë gjëmba-gjak,  
në fshatin tonë  
ka pas jetuar një pasanik  
që thirrej Stefanaq.

I pasur si vjeshta,  
i pistë si katrani,

i lumtur si princi,

i poshtër si tirani.

Në fshatin tonë

ngrihet një përmendore natyrore anës detit

ku qëndron shkumë e valë e vrull i suferinës,

gjendet një shkëmb,

që thirret «Shkëmb i Katerinës».

I çveshur si Katerina,

i heshtur si Katerina,

i zëmëruar si Katerina,

i paepur si Katerina!

## KOHË FUSHATE

Sot mos e prisni traktoristin Miti  
edhe ti, shoqe,  
edhe ju, fëmijë,  
ai është dehur nga afshi i tokës;  
sa vjet ka që e ndjen këtë erë kaq afër  
dhe kaq të afërt?

Kjo era qënka si era e bukës që sapo del  
nga furra.

Era e tokës të deh;  
aty pranë, mes ugarit, ka mbirë një lapidar  
i hershëm.  
5 veta u vranë aty për tokën nga dora gjakësore  
e pronës private.

Era e tokës të deh;  
5 burime gjaku vaditën tokën e tyre.  
Era e tokës të deh;



5 veta u vunë këtu në roje të tokës.<sup>1)</sup>  
Sot mos e prisni traktoristin Miti;  
dhe yjet i duken si luleshqerra në livadhin  
e qiellit

Sot mos e prisni traktoristin Miti.

Flini.

ai ka shumë punë,  
për ju dhe për të tjerët..:

---

1) Në vitin 1914 në fshatin Zvernec në luftë me shehun e Kaninës u vranë 3 fshatarë dhe u plagosën dy të tjerë.



## PUNËTORI I GURORES

Gjithnjë midis gurëve,  
nga mëngjesi në drekë me gurët,  
dimër e verë me gurët.  
Njëzet vjet rresht në bisedë me gurët.  
Shputat të përgjaken,  
thonjtë të mbushen me dhé,  
djersa ballit të shkon rrëke.  
Por ti e di mirë  
se këta gurë që shkulin dhe ngarkojnë  
duart e tua  
janë rrënjë kantieresh,  
këta gurë janë rrënjë uzinash dhe  
hidrocentralesh,  
janë rrënjë rrugësh, shkollash, lagjesh...  
Në sytë e tu duken qartë:  
diga, dritare plot diell,  
oxhaqe të lartë...  
Në këngën time erdhe dhe u ule, ashtu siç  
ulesh për të ngrënë drekën:

me shputa të trasha vrarë nga gurët,  
me shpërthimin e minave në zemër,  
me flokët plot cifla guri,  
me sytë plot gjallëri;  
me atë qeshjen tënde karakteristike,  
sikur do të thuash «Mirë se erdhët, shokë!»  
Të gjithëve u tha: «Mirëseerdhët!»,  
sepse të gjithë të gjejnë në punë, kur vijnë:  
Edhe diellit, që lind kështu i thua:

«Mirë se erdhë!»

dhe buzëqesh...

Je gjithmonë në rrjedhje të vazhdueshme,  
i qetë,  
i dashur,  
i kthjelltë në mendim...  
Kështu të krahasova me një burim,  
që rrjedh pa zhurmë mes gurëve.

## KËTË NATË

Që kur më the atë fjalën e thjeshtë «po»,  
nuk mundem të fle.

Kam pranë aromën e të gjithë luleve të  
pranverës,  
kam pranë fëshfërimën e të gjithë pyjeve,  
kam pranë gjelbërimin e të gjithë drurëve,  
kam pranë gjithë cicërimën e zogjve,  
kam pranë ngrohtësinë dhe ndriçimin e yjeve...

Që kur më the atë fjalën e thjeshtë «po»,  
kam në zemër zhaurimën e të gjithë deteve...

## FËMIJËT E KOPSHTIT MBLEDHIN KALLZA

Si gardalinat në arën e korrur,  
që cicërijnë të gëzuara dhe çukitin,  
fëmijët me përparëse të bardha,  
kallinj të e mbetur po mbledhin.

Habiten fëmijët e kopshtit  
me arën kokëqethur si ushtari.  
«Flokët e artë që ia krihte era,  
arës verdhoshe, kush ia mori?...»

Shikojnë fëmijët makinën shirëse  
«Si lopa po i përtyp kallinj të  
dhe gruri nëpër thasë derdhet,  
siç derdhet qumështi nga gjinj të!...»

Gëzohen fëmijët për grurin,  
që derdhet në thasë si argjënd,  
gëzohen fëmijët kur dëgjojnë:  
bukën do ta prodhojmë në vend!»

«Mirë bënë që ia prenë arës flokët,  
që andej dalka buka flori!  
Përpara, shokë të vegjël, dhe ne  
në arë të mos lemë asnjë kalli!»

## LETËR NGA KOMANDA

Faleminderit, bir,

s'ma zbehe faqen!

Gjithë jetën

mendjen dhe zemrën e kam derdhur tek ty,  
siç derdhim ne bujqit ujin në rrënjët e bimëve,  
që të na bëhen të mbara.

Deri sot,

i mbështjellë me pupla të ngrohta të dashurisë  
prindërore,

na je dukur si një zog që ende nuk di

mirë të fluturojë...

Tani që po lexojmë letrën e komandës për ty,

të shohim të burrëruar,

të shohim në fluturimin tënd të parë

tek ecën nëpër Atdhe,

i lumtur dhe i sigurtë në kohën plot diell.

Te çdo fjalë e letrës ka zjarr,

ndaj sytë e mi sot kanë kaq shumë shkëlqim,

ndaj faqet dhe balli kanë kaq dritë.

Si një gjëzim i thellë më vjen sot

zëri i tokës sonë.

Dëgjoje, bir, zërin e tokës,

zërin e tokës që na lindi,

zërin e tokës që na rriti.

Ta kesh tokën si sytë,

pa të cilët nuk sheh.

Ta kesh tokën si zemrën,

pa të cilën nuk ndjen.

Si një rrjedhje e vrullshme

më kalon mes mendimeve zëri i vjeteve të

luftës heroike.

Faleminderit, bir!

Sot më ushqeve me gëzim dhe krenari,

siç ushqen gjethi

rrënjën e tij.



## NËPËR ARTERIET E TUA

Nëpër artieriet e tua brodha tërë jetën  
si një qelizë e vogël e kuqe e re,  
në kantiere u rrita, transheve u shtriva,  
të më jesh ti i madhërishëm, Atdhe.

Mbi shpatullat e tua të ashpra  
gdhënda shkallë për brezat që vijnë,  
të ngjiten ata në majat më të larta  
dhe ty më lartë ta ngjitin lavdinë.

E përsëri jam borxhli karshi teje,  
Atdhe i dashur, për ty mendoj çdo çast.  
Me baltën tënde më rrite, më ushqeve,  
me ashpërsinë e maleve përçark.

## GJITHNJË ME POPULLIN

Del nga gjiri i popullit  
si filizi i njomë nga gjiri i tokës.  
Atje ushqehesh,  
atje shtrin krahët dhe mbushesh me fletë,  
po u shkëpute nga populli,  
mjer ti!  
Do t'i ngjash bimës që në sipërfaqe  
i dalin rrënjët,  
pastaj zverdheth ngadalë  
dhe thahet...

Ngjitesh majave të lavdisë,  
duke u mbështetur në duart milionshe  
të popullit.  
Milionat duar ngrihen,  
miliona duar të mbajnë.

Mos u shkëput nga populli!  
Ai ta jep lavdinë dhe forcën,

siç ia jepte toka fuqinë Anteut.  
Po u shkëpute, mjer ti!  
Po ia tradhtove interesat, mjer ti!  
Nga majat,  
    ku miliona duar të mbajnë,  
atje poshtë bie,  
    ku miliona këmbë të shkëllin. . ,

## GATISHMËRI

U ngjitëm. Pamja këtej është e gjerë,  
gërçhet e mprehta kurrë s'mbarojnë,  
përrenj panumër zbresin nga lartë  
e vrapin në Vjosë e ndalojnë.

Dhe ja më në fund Këndrevica  
u vesh me rrobën e gjelbër të ushtarëve,  
atje poshtë Vjosa gurgullon ngadalë  
dhe fërkohet nën këmbët e maleve.

Hapëm strehime e vendosëm pushimin.  
6 ditë pritëm me rreshjet mbi supe,  
me sy e matëm tej e mbanë kufirin,  
mbrojtja e Atdheut kërkon këto kushte.

Në copa melodish labërishte  
ngadalë-ngadalë nata bie,  
në gjumë dritash ranë malet,  
në gjumë ëndrrash Vjosa bie.

Shtrirë mbi tokën time të dashur  
në mendje një mendim i qartë rreh;  
«Me bajonetë mbërthyer duhet pritur,  
armiku i fëlliqur kurrë s' fle...»

## DITA MË E BUKUR

*(Motrës sime, ditën e pranimit në  
Parti.)*

Atë ditë  
më fuqishëm gjëmonin uzinat dhe kantieret,  
më lart ngriheshin oxhaqet dhe digat,  
më thellë zgjateshin duart e minierave në  
thellësi të tokës,  
më gëzueshëm kumbonte e qeshura e njerëzve  
të punës...

Atë ditë  
kishte më shumë ara gruri në qënien time,  
kishte më shumë tarraca dhe agrume,  
kishte më shumë kopshte me mollë, qershi...  
Kishte më shumë plantacione vreshtash,  
ullinjsh,  
kishte më shumë njerëz të lumtur.

Atë ditë  
rrëzoheshin nga piedestalet e tyre të kalbura  
koka padronësh e klerikësh,

binin intrigantë e servilë,  
binin qafëleshë e maskarenj,  
binte atje poshtë, nën këmbët e jetës së re,  
bota e vjetër...

Hidrocentralet dhe lumtëria e njerëzve  
jepnin më shumë dritë,  
lodrat dhe gazi i fëmijëve kishin më shumë  
ngjyra,  
ballet plot rrudha të nënave dhe baballarëve  
kishin më shumë flladitje,  
dhe zogjtë cicëronin më ëmbël,  
dhe lulet lëshonin aromë më shumë...

atë ditë  
kur Partia më futi në radhët e saj.

## SHUARJA E ETJES

(Në shtratin e rezervuarit të Zvernecit)

Toka ka etje.

Si milingonat,

buldozierët,  
skrepët,  
makinat...

ngarkuar me dhe

lëvizin tutje-tëhu,  
parreshtur.

Toka ka etje,

Thikat e hekurta,

thikat e rënda,

me shkëlqimin e diellit mbi vete,  
futen thellë.

Presin ashtu  
dejet e shterpësisë së tokës,  
presin ashtu  
dejet e kohës së vjetër.



Thatësira

si infantilizmi te shtatzënat  
e bënte tokën të dështonte.

Toka ka etje,

zinxhirët tendosen

dhe bëjnë përpara,

shkelin krenarisht mbi tokën e plasaritur,

sikur shkelin

mbi nofulla dhe kafka ditësh të vdekura,

ditësh,

që në përplasjen e buzëve të thara

formuan vetëm fjalën «ujë!»

Toka ka etje.

Levat tërhiqen pas gjokseve të djersitura.

Makinat e hekurta

hidhen përpara me vërtik.

Toka ka etje

ballet djersijnë

këto ditë.

Hedhim në themele veprash djersën tonë

dhe mundin tonë

Dhe do të ngrihet këtu një digë,  
dhe do të hapet këtu një sy i qeshur me ujë,  
do të rrjedhë uji nëpër këto buzë të thara tokash,  
do të rritet i shëndetshëm misri, pambuku, duhani...  
Do të gjallërohen vreshtat, agrumet, ullinjtë.  
Toka s'do të ketë etje  
në shekuj!

## BIJ TË NJË NËNE

### I.

Na ikën sonte gëzimi, hareja, humori,  
na ikën qetësia, kënga, gjumi...  
Na ikën nga trupi  
si ca zogj cicëronjës që ikin të trembur nga pema.

Nga Lushnja  
lajmi si një korb erdhi fluturim  
dhe u ul mbi degët e gjelbëra të mendimit,  
7.600 ha të shkatërruara.

Heshtje,  
mbajmë vesh si bien kokrrat e breshërit.  
Mbajmë vesh  
si ecin me hap të shqetësuar sekondat në fushën e  
kohës.

Mbajmë vesh

të rahurat e zemrës së njëri-tjetrit. . .

Jemi vëllezër!

Mbajmë vesh

dhe ndiejmë se nga cikma e lajmit të sotëm  
zemra rënqethet.

Mbajmë vesh

kuajt e hasdisur të stuhisë

shkelën dhe

thyen trupat e tyre ende qumështorë.

## II.

Ti, vëlla myzeqar, ua ndien dhembjen,

ua ndien plagën,

ua ndien klithmën.

Ke qëndruar pranë tyre netë të tëra pa gjumë,

u ke mëkuar djersën, forcat, ndjenjat.

I ke rritur si fëmijët,

u ke dhënë dashurinë e nënës

tek i shihje ashtu njomëzakë e gjelbërosh,

që harliseshin plot gjallëri,

që zgjasnin doçkat kaltërsive,

ngopeshe,

ishe i lumtur. . .

Vëlla myzeqar,

ta ndiej dhembjen;

jemi si gishtërinjtë e një dore,  
jemi si krahët e një shqiponje,  
jemi bij të një nëne.  
Mos u tremb, vëlla,  
s'je vetëm!

Partia,  
syri i pagjumë i popullit  
rri zgjuar,

Partia,  
me zemër si deti  
mbushet me dallgë shqetësimi nga  
hidhërimi i popullit.

Në rrudhat e saj  
mendimi lëviz dhe rreh  
si gjaku në venat e tij.

Partia  
bluan në thellësi të saj  
shqetësimin dhe hidhërimin e popullit.

Presin njerëzit,  
presin bimët,  
presin arat  
mes dhembjeve  
si lehonat që dështojnë në muajin e nëntë.  
Hemorragjia e dhembjes  
rrjedh cfilitëse nëpër natën e Majit.

«Përpara!

Në ndihmë të Lushnjës!»

Zëri i Partisë

përshkon tej e mbanë zemrat.

U dha kushtrimi.

### III.

Partia na thirri në një luftë të re,  
vëllai i mirë.

Kemi qarë

dhe kemi qeshur së bashku,

na ka lindur kjo tokë

dhe na ka ushqyer po kjo tokë.

Kemi një emër shqiptar,

Partia na thërret.

Përpara, pra!

### IV.

Vëlla myzeqar,

me xhamadan, me tirq e me takie të bardhë!

Kjo fatkeqësi

si një tra i rëndë ra mbi supin tënd të ashpër.

Nga pesha e rëndë

ta ndieva vështirësinë e frymëmarrjes, në të

përtpjetën që ngjitemi,

ta ndieva mpirjen dhe gjakosjen e supit, që  
mban atë peshë,  
ta ndieva dobësinë...

ndaj erdha.

Ti gëzohesh.

E marr me mend se si ndiehesh ti.

kur për hallin tënd sytë e mi skuqen nga  
pagjumësia.

kur duart e mija zgjaten drejt peshës së rëndë,  
që të ra mbi supe,

kur supet e mija vendosen përkrah supeve  
të tua

dhe pesha përgjysmohet...

Në zemrën tënde

siguria në të nesërmen hedh rrënjë.

Nesër

këto plagë, që sonte kullojnë dhembje,  
do të mbyllen

dhe Lushnja do të buzëqeshë përsëri,

si një gjoks,

si një zemër...

Me ballin lart përpara do të çajmë

si në vitin 2000,

dhe në vitin 100 mijë...

## BISEDA MË E NGROHTË

Zemra e jote, nënë Zoja,  
i ngjan një burimi të kthjellët, aty  
në Mnellën malore të Pukës;  
një burim që u ushqye nga gëzimi dhe lumturia  
e ditëve tona.

E piva ujin e kthjellët të zemrës tënde;  
e piva kur lexova në gazetën «Zëri i Popullit»  
letrën tënde;  
dhe ndieva në gjuhë shijën e ëmbël të  
Dashurisë

për këtë truall.

Ti e do këtë truall.

Shqiponja s'e braktis kurrë folenë e saj,  
as të vegjëlit e saj.

Ti e do këtë jetë,

pemët kanë dashuri për pranverën, që me  
lule e gjelbërim i vesh



dhe aspak për dimrin e zi  
që i tund,  
që i shkund  
e i çvesh.

E piva ujin e kthjellët të zemrës tënde  
dhe ndieva në gjuhë shijën e hidhur të  
kohërave të vështira, që kaloi populli ynë,  
ndjeva shijën e hidhur të fjalës «Duam bukë»!  
Dhe horizonti sikur m'u mbush me njerëz  
të reckosur,  
me njerëz fytyrëzverdhur,  
syshuar,  
duarzgjatur...

Dhe horizonti m'u mbush me varfanjakë,  
me lypsarë...  
Ndieva në vesh krismën e hidhur të pushkës së  
vëllavrasjes,  
qeshjen shpotitëse të pushtuesit, të bajraktarit,  
që qeshnin me ne,  
që derdhnim gjak  
në anfiteatrin e shekullit 20-të.  
Ndieva në zemër

dhembjen e kurbetit,  
dhembjen e ndarjes së djalit nga nënokja,  
të ndarjes së burrit nga gruaja,  
të ndarjes së babait nga fëmijët,  
të shkëputjes së rrënjës nga toka;

ndieva mugëtirën e zakonit mesjetar,  
shtypjen e gruas.

Veshët më gjëmuan nga psherëtimat e tyre,  
sytë m'u njomën nga lotët e tyre,  
grushtat m'u mblodhën para turirit të kanunit.

Piva në kthjelltësinë e zemrës tënde  
dhe ndieva peshën e hidhur të lajmit ogurzi,  
që rend nëpër shkrepaz:

«Hej u vra...»,  
kur vdekja mbante jetën në kthetra.  
Dhe m'u shfaq katili  
me kokën e Kolë Biba Mirakës mbi zverk,  
më doli katili me pushkën e tradhtisë  
mbi supe,  
katili me sytë e kukuvajkës,  
katili me dhëmbin helmues të nëpërkës.

Pastaj ndieva ngrohtësinë e fjalës «U vra për  
Atdhe!»

Dhe hapësira m'u mbush me lapidare,  
me yje të pashuar, që ndrijnë.

Tani që po e lexoj letrën tënde  
ndiej si fryn era e trimërisë.  
Më shfaqet para syve Nora malësore,



si një lule e çelur që kthehet drejt diellit,  
t'i dhurojë buzëqeshjen,  
mirënjohjen...

Ndaj ngrihesh në këmbë  
dhe mbështetesh pas Partisë,  
siç ngrihet dhe mbështetet bajoneta  
pas pushkës,  
mes stuhisë  
me një urdhër,  
me një sinjal të vetëm.

Kështu, pra,  
sot grushti yt u ngrit lart  
pranë ballit me rrudha  
dhe flokut të thinjur:

Betohemi!

Jeta ime

dhe jeta e djalit tim

të tuat janë, Parti!»

Ndaj dhe luginat oshëtijnë:

«Betohem!»

Ndaj dhe gurët shtërngojnë grushtat:

«Betohem!»

Ndaj dhe kupa e qiellit përgjigjet:

«Betohem!»

«Betohem!»

«Betohem!»

Gjoksi yt është një pozicion i pakalueshëm,  
një istikam  
nga ku shtijnë parreshtur idealet e komunizmit,  
horizonti mbushet me krisma dhe gjëmime.  
Armiqtë rrëqethen.  
Armiqtë tkurren,  
struken në vrimat e tyre të errëta...

Partia  
ngre grushtin  
mbi ballin e saj.  
«Betohem!»  
Qiejtë bubullijnë.  
Malet shungullojnë.  
«Për lumturinë e popullit!  
Betohem!»

## POEMË

### LULE, DJEMTË E NËNAVE!

Partizanëve shqiptarë, që ranë për çlirimin e tokave të Jugosllavisë, eshtrat e të cilëve erdhën në tokën tonë në dhjetor.

1975.

Mirë se vini!

Gjiri i ngrohtë i nënës iu pret.

Ka lule.

Ka gjelbërim.

Ka cicërimash zogjsh.

Diell.

Kaltërsi...

Mirë se na vini, bijë!

Populli mban mbi supe arkivolet e tyre.

Ecje.

Pse kanë ulur kokat flamujt ndaj udhës?

Pse heshtin njerëzit?

Ç'janë këto pika kristali në sytë e dhembjes,

që rrukullisen në pafundësi?

Populli mban mbi supe arkivolet e tyre.  
Populli mban në zemër hidhërimin e tij.

Mirë se vini!

Ardhje e rëndë kjo.

Ardhje plagësh,  
stuhish...

Nuk deshëm të na vinit nëpër arkivole,  
nuk deshëm të na vinit nga rruga e hidhur e  
ndarjes.

Nuk deshëm të na vinit të shpuar nga plumbat,  
të copëtuar nga predhat  
dhe minat.

Nuk deshëm jo, kurrë kështu!

Eh, si deshëm ne!

Deshëm t'u prisnim ndanë udhëve  
me këngë dhe valle,

deshëm t'u prisnim me diell në fytyra,  
me lule në duar,

me flamurë që valëvitën krenarisht,  
me krahë dhe gjokse të ngritura...

Deshëm, që flladi i lirisë të gufonte  
zëmrat tona dhe tuajat.

Deshëm që dielli i Lirisë të mbushte me dritë  
sytë tanë dhe tuaj...

Mirë se vini!

Ju vini drejt nesh të gjallë,

duke mbajtur mbi supe dimrin e vitit '44,  
duke mbajtur mbi supe borën dhe plumbat,  
duke mbajtur mbi supe peshën e rëndë që  
iu ngarkoi Atdheu.

I ashpër ish ky fillim dhjetori.  
Nga vjetet që shkuan u ngrit kjo erë zëmërimi  
dhe fryn.

Në fytyrat tona,  
në grushtet tona,  
në zemrat tona...  
Na morët djemtë, katilë!

Na plagosët zemrat, katilë!  
Hodhët sharpin e zi mbi kokën e nënës,  
sharpin e zi.

Por nëna nuk u lëkund,  
Shqipëria nuk ra.  
Kujtoni Albulenën,  
kujtoni Drashovicën, Tendën e Qypit!

Mirë se vini!

Mbi supe mbartni rrezet e një dielli të madh,  
mbi supe mbartni rrezet e një dielli plot zjarr,  
që ndrit,  
që ngroh  
dhe verbon.

mbi supe mbartni internacionalizmin

proletar!



Shqipëria një pëllëmbë,  
barut dhe hekur ka përtypur me dhëmbë!

Mirë se vini, vëllezër, bij!  
Sikur globin ta kishte dau!le Liria,  
do t'i binte për ju, solemnisht:  
«Erdhën partizanët!»  
Dhe s'është hera e parë që gjaku ynë po vadit  
rrënjët e miqësisë së popujve.  
Sot në pritjen tuaj janë mbledhur  
të gjithë popujt.

Brohorisin popujt:  
«Rrofshin herojtë!»  
Brohorisin popujt:  
«Viva camaradas!»

Mirë se vini!  
Popujt mbartin në kujtesën e tyre portretin tuaj,  
me buzëqeshjen si Liria,  
me sytë plotë diell,  
me kapelen në ballë  
dhe në sup maliherin.

Populli mbart në kujtesën e tij portretin tuaj.  
Nga vitet vini  
e si një shtëllungë ere nëpër kohëra të reja  
fryni.  
Nga plagët tuaja thirrja «hakmarrje!» na ndoqi  
në çdo ditë, që shkelëm,

përherë besnikë  
përherë të paepur në idealet tuaja ngelëm.  
Nga fronti vini,  
                    luftëtarë besnikë,  
qysh prej një ndarjeje të gjatë,  
do çuditëni me tokën tonë që është mbushur  
  me fusha të blerta  
dhe me oxhaqe të lartë.

Dhe do të buzëqeshni me njerëzit e lumtur,  
                    pa brenga, që i shponin si thikë.  
Do të buzëqeshni me fëmijët.  
Do të gëzoheni që gjakun tuaj e bëmë dritë.

Mirë se vini!

                    Toka nënë ju pret.  
Nga thellësia e zemrës si llavë ngrihet  
  urrejtja mbi kraterin e saj-

Gjëmon

Shfryn.

Shkund.

Djeg e përvëlon.

Në këtë llavë digjen të gjithë mizorët,  
që nga tradhtarët

                    e gjer te agresorët.

Në këtë llavë u dogj dhe nata më e zezë  
  e shekullit të njëzetë.

U dogj si një krah korbi,  
  u shkrumbëzua

nata me fytyrë bishe,  
nata me sy kryqesh të thyer,  
nata me çizme të rënda,  
nata nën kapotë strukur,  
nata me gjak popujsh lyer...  
Kështu do të digjen të gjithë të liqtë,  
si ata që ikën,  
si ata që vijnë...

Mirë se vini, shokë!  
Kjo ardhja juaj si një thirrje në vesh të kohës:  
«Mos e lini murtajën të ngjallet!»  
Kjo ardhja e juaj si një parrullë vigane, që  
ka mbështjellë gjithë globin  
me shkronja të mëdha,  
me shkronja të zjarra,  
me shkronja gjaku:  
«Popuj, vigjëloni!»

Kjo ardhja e juaj  
si një gisht tregues mbi bishën, që kërkon  
të mëkëmbët:  
«Ja ku është!  
Mos e lini të ngrihet!»

Mirë se vini, shokë!  
Nëna, përherë nënë mbetet;  
e dashur,  
e dhimbshur,

e drejtë...

Me duart të zgjatura drejt jush,  
në gjirin e saj të ngrohtë,  
në zemër dhe në buzët e saj,  
në gjakun dhe në mendimet e saj  
pavdekësia juaj qëndron përherë e re:  
«Lule, djemtë e nënave!»

## PASQYRA E LËNDËS

### Vjersha

### Faqe

— Këngët e popullit tim .....	3
— Grushtet e shtrënguar .....	5
— Kam nevojë .....	7
— Në vaporin e mbytur .....	8
— Duke ardhur .....	9
— Në çaste hidhërimi .....	10
— Bashkëfshatarët .....	11
— Merimanga .....	12
— Shkëmbi i Katerinës .....	14
— Kohë fushate .....	16
— Punëtori i gurores .....	18
— Këtë natë .....	20
— Fëmijët e kopshtit mbledhin kallza .....	21
— Letër nga komanda .....	23
— Nëpër arteriet e tua .....	25
— Gjithnjë me popullin .....	26
— Gatishmëri .....	28
— Dita më e bukur .....	30
— Shuarja e etjes .....	32
— Bij të një nëne .....	35
— Biseda më e ngrohtë .....	40

### POEMË

— Lule, djemtë e nënave! .....	46
--------------------------------	----